

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit lidhet me datë 20.05.2021 ndërmjet:

1. **Fondacioni BONEVET Gjakovë**, me numër të regjistrimit **5200307-5**, organizatorë të garës **Climate Launchpad Kosovo 2021**, të përfaqësuar nga z. Arbër Lleshi (mëtitje **BONEVET**) dhe
2. **Komuna e Gjakovës**, përfaqësuar nga z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës (mëtitje **Komuna e Gjakovës**)

Neni 1 - Objekti dhe qëllimi i marrëveshjes

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje pajtohen të bashkëpunojnë për promovimin në Komunën e Gjakovës të garës më të madhe ndërkombëtare për 'green startups' - Climate Launchpad - projekt jopërfitues dhe në të mirë të shoqërisë, i cili organizohet për herë të parë në Kosovë (për herë të parë dhe në Ballkan) nga BONEVET, dhe ka për qëllim përkrahjen e bizneseve të reja që janë miqësore dhe kontribuojnë për ambientin.

Neni 2 - Përfitimet dhe obligimet e palëve sipas marrëveshjes

1. Të dy palët nënshkruese, përmes Climate Launchpad, bëhen përkrahëse të bizneseve të reja në Gjakovë dhe poashtu kontribuojnë në mbrojtjen e ambientit.
2. Komuna e Gjakovës bëhet partner dhe aleat strategjik i Climate Launchpad Kosovo 2021.
3. BONEVET zyrtarizon Komunën e Gjakovës si partner institucional të Climate Launchpad Kosovo 2021 dhe vendos logon e Komunës së Gjakovës në të gjitha materialet digjitale dhe fizike promovuese relevante.
4. Komuna e Gjakovës zotohet që të ndaj, kohë pas kohe, në website dhe rrjetet sociale të veta informatat për garën Climate Launchpad Kosovo 2021, përmbajtja e të cilave mund përgatitet së bashku me BONEVET, sipas përshtatshmërisë.

FONDACIONI
BONEVET
GJAKOVË

Komuna e Gjakovës

REPUBLICA E KOSOVËS
Komuna e Gjakovës
Kuvendi i Komunës
10